



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:037025

Datë: 08.03.2021

Numri i dokumentit: 01574341

P.nr. 101/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 prg.6 lidhur me prg.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.224/2020 të datës 05.03.2020, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më datë 25.06.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.NR.224/2020 të datës 05.03.2020, andaj gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

A. M., nga i ati Z., i lindur me dt.... në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ku dhe tani jeton, me nr. Personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak të dyshimit të bazuar mirë se:

Nga data e pavërtetuar e gjerë me dt.12.11.2019 në shtëpinë e tij në fshatin Ratkoc, Komuna Rahovec, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë në kundërshtim me Ligjin për Energji Elektrike nr.05/L-085 të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që gjatë kontrollës është konstatuar se i pandehuri jashtë njehsorit elektrik me numër 32591204 përmes një kablllo 4x6 mm është kyçur direkt në rrjetin elektrik dhe

me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës K.-distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 96.88 euro.

-Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314/6 lidhur me prg.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69,70, 314/6-1 të KPRK-së, nenit 365 dhe 493 të KPPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumën prej njëqind (100) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën sipas nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të burgimit me nga njëzetë (20) euro.

E dëmtuara K. – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.224/2020 të datës 05.03.2020, kundër të akuzuarit A. M., nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 prg.6 lidhur me prg.1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarës.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 493 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë:
-Procesverbali mbi konstatimin gjendjes faktike me dt.12.11.2019 me nr.2531780;
-Fatura e rikthimit të humbjeve DGJHP198897 të datës 13.11.2018;
-Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata konstaton se këto prova janë bindëse, të besuara dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore-juridike të realizojë në procedurën civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.101/2020 me datën 25.06.2020

Sekr. Juridike
Shemsije Shehu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit, për Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec.